



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:173568  
Datë: 08.09.2023  
Numri i dokumentit: 04660311

C-I-22-0006

**D H-DHC-I L.L.C, NRB: 811395723...**,  
**A D, avokat** nga Prishtina,

*Paditësi*  
të cilin e përfaqëson

*Kundër*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

*E paditura*

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), Kolegji i përbërë nga Shkelzen Sylaj gjyqtar kryesues, Sylejman Shumolli dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me datë 08 shtator 2023, lëshon këtë:

**A K T V E N D I M**

- Gjykata jep pëlqimin për tërheqjen padisë së paditësit i cili ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës Nr.Ref. BD-167/41, të dt. 28 korrik 2022, ashtu që padia konstatohet e tërhequr.**
- Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale:**

Me 16 gusht 2022, paditësi ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS), padi për anulimin e vendimit Nr.Ref. BD-167/41, të dt. 28 korrik 2022, të Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) si dhe propozim për masë të sigurimit.

Me 10 gusht 2023, përfaqësuesi i paditësit avokati A D paraqiti në Gjykatë një parashtrësë për tërheqje të padisë kundër të paditurës Agjencia Kosovare e Privatizimit, me arsyetimin se paditësi me të paditurën i kanë zgjidhur mosmarrëveshjet në mes vete.

Për detaje tjera referim behet tek dosja e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Neni 34 paragrafi 1 i Ligjit Nr.06/L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parasheh:

*“ Paditësi mund ta tërheqë kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme.... ”*

Gjykata jep pëlqimin për tërheqjen e padisë së paditësve, sepse nuk është në kundërshtim me interesin e ndonjërës palë.

### **Shpenzimet Gjyqësore**

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

### **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar Kryesues

Sylejman Shumolli, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare